

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE “Albanica Travel & Tours” sh.p.k.

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë , në ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit” , të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe te ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.B dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare , me vullnetin e tij të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi në ortaket:

1- Ivi Xhufka, i datëlindjes 20.12.1991, lindur në Tiranë dhe banues në adresën **Rruga Gramshi, 75 Kamez-Tiranë**, identifikuar me pasaporte me nr BJ1034668 dhe me nr.issH J11220115K, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Krijon shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Albanica Travel & Tours**” sh.p.k me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**ALBANICA TRAVEL & TOURS**” sh.p.k. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private “**Albanica Travel & Tours**” sh.p.k do të ketë seline **Rruga Gramshi, banesa nr.75, kati II, Kamez Tiranë, Shqipëri**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e:

1) Ushtrim i veprimtarisë së lire private në fushën e turizmit përputhje me legjislacionin në fuqi si operator turistik. Organizim i grupeve ndryshme turistike vendas dhe të huaj dhe kryerja e

guidave turistike me ta. Akomodim i grupeve te ndryshme turistike ne hotele, fshatra turistike, kampingje, shtepi pushimi, restorante, etj. Shoqerim me perkthyes dhe cicerone i grupeve te ndryshme turistike ne guidat e tyre Brenda dhe jashte vendit. Organizim dhe kryerje e sherbimit te ndermjetesimit, te perfaqesimit dhe te komisionerise me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj per kryerjen e veprimtarive te ndryshme turistike. Organizim dhe kryerje e veprimtarive te ndryshme me turiste vendas dhe te huaj, si hipizem, motoçiklizem, gara makinash, biçikletash, etj. Organizim dhe kryerje e transportimit te turisteve vendas dhe te huaj me mjete te ndryshme te transportit tokesor, te vet shoqerise apo te marra me qira ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin e lejuar.

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë dhe për çfardo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private “ **Albanica Travel & Tours** ” sh.p.k do te jetë **100,000 (njëqindëmijë)** lekë

Kapitali është i ndarë në **1 (një)** kuotë të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej **100,000 (njëqindëmijë)** lekë për çdo kuotë.

Kapitali përbëhet 100% nga kuotat e ortakëve. Ortak i shoqërisë “**Albanica Travel & Tours**” SH.P.K., është:

1-Z.Ivi Xhufka i cili zotëron **100%** të pjesëve të kapitalit të shoqërisë dhe përkatësisht **1 (një)** kuotë.

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj.

Administratori shoqërisë do të jetë Z.Ivi Xhufka me pasaporte me nr BJ1034668 dhe nr. ISSH J11220115K

Ai është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut Ivi Xhufka në proporcion me kuotat.

Neni 8

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financiarë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të Legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 3 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “ **Albanica Travel & Tours** ” sh.p.k . Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët. Ortaku themelues i shoqërisë “**Albanica Travel & Tours**” sh.p.k., është Z. Ivi Xhufka. Sot me datë 28.05.2024, në Tiranë, u draftua dhe u nënshkrua me vullnetin e plotë dhe të lirë të Ortakut, Akt Themelimit të “**Albanica Travel & Tours**” sh.p.k., në 3 kopje, në gjuhën Shqipe, dhe me të njëjtën vlerë ligjore.

Ivi Xhufka 